



<b>TË DHËNAT PËR ASETIN</b> <b>Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.71</b> <b>Njësia e Vendosur në Tender Nr.15</b> <b>KB Ereniku-Parcela nr.178-0 në Zhub</b>	
<b>Emri i NSH.-së</b>	KB Ereniku- Prodhimtaria Primare, Gjakovë (“Ndërmarrja”)
<b>Lloji i shitjes</b>	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
<b>Dita e Ofertimit</b>	Më 16.04.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
<b>Çmimi minimal</b>	540 €/ari
<b>Depozita e Ofertës</b>	€ 1,000
<b>Kategoria potenciale për shfrytëzim</b>	Rezidenciale
<b><u>Përshkrimi i Aseteve</u></b>	
<b>Vendndodhja e Aseteve</b>	Zona Kadastrale Zhub, Komuna Gjakovë Të dhënat e hartës ©2024 Google <a href="#">Shikoni këtë pronë në Google Maps</a> Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe 1358m <sup>2</sup> (13ari 58m <sup>2</sup> ), me kulturë Kullosë e klasës 4, në vendin e quajtur “Kodra Kabash” e cila shtrihet në anën veriore të ZK Zhub, Komuna Gjakovë. Parcela kadastrale më nr të njësisë 178-0 shtrihet në veri të zonës kadastrale Zhub. -Në anën veriorë të parcelës kalon rruga fushore, e cila shfrytëzohet nga parcelat fqinje. -Përgjatë anës lindore & perëndimore parcela është e rrethuar me kunja druri. -Përgjatë anës lindore parcela ka qasje ne rrugë publike. <b><u>Vërejtje:</u></b> Në anën perëndimore të parcelës kadastrale me nr 178-0 ekziston rrethojë faktike teli nga pala fqinje për të cilën është e nevojshme matje precize në terren për të përcaktuar saktë nëse kjo rrethojë ndodhet apo jo në pronën e NSH-së. Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.
<b>Shfrytëzuesit</b>	Nuk ka ndonjë marrëveshje për shfrytëzimin e asetit në shitje.
<b>Asetet tjera</b>	Nuk ka.
<b>Detyrimet që do të barten</b>	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



**Foto/fotot  
ose informata të tjera  
për asetet në shitje**





Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org).




ERENIKU PP-PARCELA KADASTRALE 178-0 NË ZK ZHUB,  
KOMUNA GJAKOVË



Kjo hartë është përgatitur vetëm për orientim.

Palët e interesuara këshillohen që t'iu referohen Çertifikatave mbi të Drejtën e pronës së Paluajtshme për sipërfaqe dhe specifikat tjera.

Legjenda:

-  Parcela kadastrale 178-0 S=1358m<sup>2</sup>
-  Rrugë publike



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

0 5 10 15  
Meters



RAPORT NGA VIZITA NË TERREN  
KBI ERENIKU-Parcela kadastrale 178-0 në ZK Zhub

Me datë 09.01.2025 zyrtarët e AKP ZR Pejë prezent në terren ishim unë Bleria Jashari Kastrati Zyrtare kadastrale dhe Memli Dula Zyrtar i operacioneve për administrim të aseteve për identifikimin e tokës e cila sipas certifikatës së pronës evidentohet në pronësi të "P.SH.KBI ERENIKU" Z.K Zhub, Komuna Gjakovë.

Toka është e regjistruar në certifikatën e pronësisë, parcela kadastrale me nr të njësisë P-70705033-00178-0 me sipërfaqe 1358m<sup>2</sup> me kulturë Kullosë e klasës 4 1/1 në vendin e quajtur "Kodra Kabash".



Fig.1 Ortofoto, parcela kadastrale 178-0 ZK Zhub, K.Gjakovë

Nga vizita në terren konstatuam këtë gjendje:

- Parcela kadastrale me nr të njësisë 178-0 shtrihet në veri të zonës kadastrale Zhub.
- Në anën veriore të parcelës kalon rruga fushore, e cila shfrytëzohet nga parcelat fqinje.
- Përgjatë anës lindore & perëndimore parcela është e rrethuar me kunjë druri.
- Përgjatë anës lindore parcela ka qasje në rrugë publike.



**Vërejtje:** Në anën perëndimore të parcelës kadastrale me nr 178-D ekziston rrethojë faktike tëll nga pala fqinje për të cilën është e nevojshme matje precize në terren për të përcaktuar saktë pozicionin e kësaj rrethoje në terren.

Fig. 2 Fotografitë e mëposhtme paraqesin gjendjen faktike në terren:



Zyrtare Kadastrale Rajonale:  
Blerita Jashari Kastrati

Zyrtar i operacioneve për administrim të asetëve:

Megrit Dula

Faqe 2 / 2

**Informatat dhe  
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik  
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090,2059  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rr. Dritan Hoxha, nr.55  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës